



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



Paligjshmëria e MPMS-së ndaj personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik



Prishtinë, janar 2021

01/2021

Autorët: Leotrim Gashi dhe Tringa Ramadani

Ekipi redaktues: Yll Zekaj, Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

QNJ-IKD:

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@ndihmajuridikeikd.org

E: info@kli-ks.org

www.ndihmajuridikeikd.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Mbrojtja ligjore e personave me aftësi të veçanta	5
2.1. Rregullimi ligjor i personave paraplegjik dhe tetraplegjik	6
3. Paligjshmëria e MPMS-së gjatë periudhës së pandemisë Covid-19	7
4. Trajtimi i palëve të QNJ-IKD-së nga ana e MPMS-së.....	10
<input type="checkbox"/> Sh.M k. MPMS	10
<input type="checkbox"/> U.B k. MPMS	11
<input type="checkbox"/> K.S k. MPMS	11
<input type="checkbox"/> V.V k. MPMS	11
<input type="checkbox"/> I.M k. MPMS	12
5. Rekomandime.....	13

1. Përmbledhje ekzekutive

Integrimi në shoqëri i personave me nevoja të veçanta pa dyshim se mbetet një nga obligimet më të rëndësishme të të gjitha shteteve të cilat kanë për synim promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Mos trajtimi i kësaj kategorie shoqërore sipas nevojave të tyre paraqet diskriminim.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përmes implementimit të drejtpërdrejtë të Konventave Ndërkombëtare, ka garantuar që personat me nevoja të veçanta duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat themelore të tyre pa qenë të diskriminuar nga askush. Ndërsa përpos tyre, në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të veçanta, Kosova ka miratuar edhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Ligji Nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik ka për qëllim rregullimin e statusit dhe të drejtat e personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit, kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo të sipërme. Të gjithë përfituesit e këtij ligji mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit, ku ndër të tjera është paraparë që ata të marrin kompensim të caktuar nga buxheti i Republikës së Kosovës si dhe përfitime të tjera.

Mirëpo, edhe pse ky ligj dhe Rregullorja për funksionimin e Komisionit Vlerësues për përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit të këtyre personave ka përcaktuar rregulla të qarta për mënyrën e vlerësimit të personave të cilët aplikojnë që ta gëzojnë një pension nga ky ligj, ka rezultuar se gjatë periudhës së pandemisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), si organ kryesor që duhet të vë në zbatim dispozitat e këtyre ligjeve, të shkel pikërisht këto akte.

Në bazë të pesë (5) rasteve të cilat Qendra për Ndihmë Juridike Falas (QNJ) që funksionon në kuadër të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) i ka pranuar gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2020, ka rezultuar se MPMS-ja ka bërë rivlerësimin e personave të cilët kanë fituar statutin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik që nga viti 2017, duke mos respektuar obligimet që dalin me ligjin dhe rregulloren që e trajton këtë çështje, pasi ka vendosur të bëjë rivlerësimin e tyre pa i ftuar palët në ekzaminim fizik, duke u mjaftuar vetëm me dokumentacionet mjekësore të cilat palët i kanë dorëzuar në vitin 2017, kur ata edhe e kishin fituar këtë status. Përveç tyre, sipas të dhënave të MPMS-së, në procesin e rivlerësimit gjatë periudhës së pandemisë (mars-dhjetor 2020), pas refuzimit të palëve që më parë kanë qenë përfitues të Ligjit, janë bërë 319 ankesa, 261 prej të cilave janë refuzuar edhe në shkallën e dytë të MPMS-së, përmes disa vendimeve kryesisht shabllone.

Ndërsa, edhe pse përmes procedurës ankimore përcaktohet që të eliminohen gabimet eventuale të shkallës së parë, në praktikë rezulton se Komisioni i Ankesave i MPMS-së ka bërë gabimin e njëjtë duke mos përmirësuar shkeljet e Komisioneve vlerësuese.

QNJ-IKD rekomandon që duke marrë parasysh periudhën e vështirë me pandeminë Covid-19, MPMS-ja duhet që të ndal mohimin e të drejtave ligjore të personave të cilët tash e tre (3) vite marrin kompensim nga MPMS-ja dhe në një periudhë sa më të shpejtë kohore të bëjë edhe një rivlerësim për personat që janë rivlerësuar pa u bërë ekzaminime fizike në zyrrat rajonale të ministrisë.

2. Mbrojtja ligjore e personave me aftësi të veçanta

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se të gjithë janë të barabartë para ligjit, çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore dhe se askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.¹ Përveç Kushtetutës, të drejtat themelore të personave me nevoja të veçanta, janë të garantuara edhe me shumë akte ndërkombëtare të cilat zbatohet drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, e të cilat kanë prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.²

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili gjen zbatim të drejtpërdrejtë në Kosovë, ka përcaktuar që të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë në mbrojtje të barabartë para ligjit, pa kurrfarë dallimi.³ Mbrojtja nga diskriminimit është paraparë edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën Evropiane

për të Drejtat e Njeriut, si akte me zbatim të drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Për më tepër, përmes Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut është përcaktuar edhe e drejta për një nivel jetese të mjaftueshme, e cila i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme, si të personit ashtu edhe të familjes së tij.⁴

Kosova, në fushën e mbrojtjes së personave me aftësi të veçanta ka miratuar Ligjin nr. 04/l-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, Ligjin nr. 03/l-019 Për Aftësimin, Riaftësimin profesional dhe Punësimin e personave me aftësi të Kufizuara, Ligjin nr. 05/l -067

Për statusin dhe të Drejtat e Personave Taraplegjik dhe tetraplegjik dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore, me të cilat janë rregulluar të drejtat e personave me aftësi të veçanta dhe obligimet e institucioneve për t'iu përkrahje të kësaj kategorie të shoqërisë.



¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 24, paragrafi 2. (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>). (Qasur për herë të fundit më 05.01.2021).

² Po aty. Neni 22.

³ Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Neni 2.3. (shih linkun:

<https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 05.01.2021).

⁴ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. Neni 25 (Shih linkun: <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/Deklarata%20Universale%20e%20te%20Drejtave%20e%20Njeriut%20%281948%29.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 05.01.2021).

2.1. Rregullimi ligjor i personave paraplegjik dhe tetraplegjik

Ligji nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, i cili ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2016, ka për qëllim rregullimin e statusit dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit, kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.

Të gjithë përfituesit sipas këtij ligji mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit dhe të gjithë gëzojnë të drejtën në kompensim të caktuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në pagën minimale. Po ashtu, ky ligj u ka njohur përfituesve të drejtën në kujdestar personal, bazuar në vlerësimin e komisionit vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, të cilët, po ashtu kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji.

Përpos kompensimit material, përfituesve të këtij ligji u është njohur edhe e drejta për lirim nga taksat dhe tatimi, përkujdesja për strehim, qasja më e lehtë në arsimim, kujdesi i shtuar shëndetësor, reduktim në tarifa të konsumimit të energjisë elektrike e po ashtu edhe lirim nga pagesa e udhëtimit të trafikut urban.

Bazuar në Rregulloren për Përbërjen, Funkionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik,

Komisioni vlerësues i MPMS-s është autoriteti kryesor i cili përcakton se kush mund të gëzoj statusin e personit paraplegjik dhe tetraplegjik dhe rrjedhimisht edhe t'i njihen të drejtat të cilat garantohen me ligj.

Në nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të kësaj Rregullore, është përcaktuar se përfituesit e grupit të parë janë personat me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë dhe humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve, ndërsa përfituesit e grupit të dytë janë persona që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë dhe humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve.

3. Paligjshmëria e MPMS-së gjatë periudhës së pandemisë Covid-19

Ligji Nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik (Tutje: *Ligji*) dhe Rregullorja për funksionimin e Komisionit Vlerësues për përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit të këtyre personave (Tutje: *Rregullorja*) ka përcaktuar rregulla të qarta për mënyrën e vlerësimit të personave të cilët aplikojnë që ta gëzojnë një pension nga ky ligj.

Në anën tjetër, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) më 11 mars 2020 e ka shpallur virusin korona COVID-19 si pandemi, derisa rastet e para me COVID-19 në Republikën e Kosovës janë konfirmuar më 13 mars 2020.

Me qëllim të mbrojtjes nga pandemia COVID-19, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte shpallur gjendjen e emergjencës shëndetësore dhe kishte ndërmarrë masa të shumta kufizuese me qëllim të parandalimit të pandemisë COVID-19.

MPMS si institucioni kryesor që duhet të vë në zbatim dispozitat e ligjit dhe rregullores, gjatë kësaj periudhe kishte bërë të kundërtën, pra po kjo ministri kishte shkelur këto akte.

Në bazë të pesë (5) rasteve të pranuar nga QNJ-IKD gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2020, QNJ-IKD ka gjetur se MPMS-ja ka bërë rivlerësimin e personave të cilët e kanë pasur të fituar statutin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik nga viti 2017, duke mos respektuar obligimet që dalin me

ligjin dhe rregulloren që e trajton këtë çështje, pasi ka vendosur të bëjë rivlerësimin e tyre pa i ftuar në ekzaminim fizik, duke u mjaftuar vetëm me dokumentacionet mjekësore të cilat palët i kanë dorëzuar në vitin 2017, kur ata e kishin fituar këtë status.

Përveç këtyre palëve, sipas të dhënave të MPMS-së, në procesin e rivlerësimit, pas refuzimit të palëve që më parë kanë qenë përfitues të Ligjit, gjatë periudhës mars-dhjetor 2020 janë bërë 319 ankesa, prej të cilave për vetëm 14 prej tyre është kërkuar dokumentacion shtesë dhe këto raste janë ende në procedurë, 261 raste të tjera janë refuzuar edhe në shkallën e dytë të MPMS-së, derisa në 44 raste ka mbetur në fuqi vendimi i mëparshëm.⁵

Sipas MPMS-së, rivlerësimi i palëve është bërë pa prezencën e palëve vetëm në muajin gusht, dhe atë për shkak të pandemisë COVID-19:

“Sa i përket komisioneve vlerësuese me përjashtim të kohës së pandemisë që në muajin gusht në bazë të vendimit të Ministrisë të datës 12.08.2020 janë shqyrtuar dosjet pa prezencën e palës dhe atë vetëm rivlerësimet nga të gjitha regjionet/ Sa i përket shqyrtimit të ankesave ligji nuk e parasheh prezencën e palës por në disa raste komisioni e fton palën a po edhe kemi raste kur vetë pala me rastin e parashtrimit të ankesës kërkon që me rastin e shqyrtimit të ankesës të jetë prezent. Po ashtu në disa raste në bazë analizës së raporteve mjekësore që gjenden në dosje komisioni mjekësor vlerëson se pala duhet të sjell plotësim të

⁵ “(Pa) Drejtësia e shtetit ndaj personave me nevoja të veçanta”. Betimi për Drejtësi. 26.12.2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/pa->

[drejtësia-e-shtetit-ndaj-personave-me-nevoja-te-vecanta/](https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/pa-drejtësia-e-shtetit-ndaj-personave-me-nevoja-te-vecanta/)). (Qasar për herë të fundit më 05.01.2021).

*dokumentacionit prandaj edhe ftohet pala dhe udhëzohet që të sigurohet ekspertiza e caktuar nga QKUK*⁶.

QNJ-IKD vlerëson se një formë e tillë e veprimit nga ana e MPMS-së paraqet mohim të së drejtave ligjore të kësaj kategorie të ndjeshme të shoqërisë. Kjo mënyrë e veprimit bie në kundërshtim me nenin 9 të Rregullores, i cili thotë se “*Në bazë të vlerësimit të Komisionit Vlerësues, përfituesit e grupit të parë me pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve do t'i nënshtrohen rivlerësimit në çdo pesë vite, kurse për përfituesit e grupit të dytë që nuk kanë pasoja të përhershme dhe të plota me inkontinencë, humbje të plotë të ndjeshmërisë së ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të dekubituseve rivlerësimi konform Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik*”.

Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 17 të Ligjit në fjalë [Komisioni Vlerësues], në të cilin ligj është referuar edhe Rregullorja, thotë se “*Përfituesit e këtij ligji i nënshtrohen vlerësimit të Komisionit Vlerësues të MPMS, në zyrat rajonale*”.

Po ashtu, duke vepruar në këtë mënyrë, në këtë procedurë të rivlerësimit, Komisioni Mjekësor ka rënë në kundërshtim edhe me nenin 5 të Rregullores, në të cilin përcaktohen funksionet dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues, konkretisht paragrafin 1, pika 1.1. me të cilin përcaktohet obligimi për “*Ekzaminimin e*

parashtruesit të kërkesës”, dhe 1.2 “*Vlerësimin e grupimit dhe nevojave sociale të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, e cila bëhet duke u bazuar në dokumentet mjekësore, mendimin konziliar nga Klinika e Neurologjisë-QKUK, si dhe ekzaminimit nga ana e Komisionit Vlerësues*”.

Në këtë formë, QNJ-IKD konkludon se MPMS-ja nuk ka vepruar sipas mënyrës së përcaktuar me Ligj dhe Rregullore sepse duke vendosur pa e parë gjendjen reale të aplikuesit dhe dokumentacionit shtesë që mund të kishin palët që është dashur të rivlerësohen, si shkalla e parë e vendosjes, ashtu edhe Komisioni i Ankesave kanë marrë vendime të cilat kanë shkuar në dëm personave që për tri (3) vite me radhë kanë qenë përfitues të këtij ligji dhe me këtë mënyrë të vendimmarrjes është dëmtuar një kategori shumë e ndjeshme shoqërore.

Ndonëse Kushtetuta, si akti më i lartë juridik, e po ashtu edhe marrëveshjet ndërkombëtare promovojnë, mbrojnë dhe sigurojnë gëzimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, personat me aftësi të kufizuar, përfshirë këtu paraplegjikët dhe tetraplegjikët, si kategori e veçantë, janë bartës të pasojave si rezultat i shkeljeve ligjore dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike. Në fakt, në rastin konkret nuk kishte fare konstatim të gjendjes faktike.

Ndërsa edhe pse me procedurën ankimore si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, parashihet që të eliminohen gabimet eventuale të shkallës së parë, në praktikë rezulton se Komisioni i Ankesave i MPMS-

⁶ Intervistë përmes postës elektronike me U.d. Drejtorin e Departamentit të Pensioneve në MPMS, Izet Shala. 18 janar 2020.

së ka përdorë vendime shabllone të cilat ndryshojnë vetëm emrat e palëve dhe datat e takimeve të komisioneve mjekësore, pasi në përmbajtje, ato vendime janë pothuajse identike meqë nuk japin asnjë lloj arsytimi për secilin pretendim ankimor të palës që bënë ankesë. Në rastet e refuzimit të ankesave, komisionet e ankesave kanë bërë vetëm konstatimin se pala që ka paraqitur ankesë nuk i plotëson kushtet që ta fitoj statusin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, derisa këtë dispozitiv nuk e kanë arsyetuar sipas standardeve të kërkuara.

Një qasje e tillë e MPMS-së, me të cilin nga 387 ankesat e palëve të refuzuara pa praninë e tyre në zyrat rajonale të ministrisë, janë refuzuar 364 ankesa dhe vendimet e këtyre refuzimeve janë bërë vetëm në mënyrë abstrakte dhe shabllone, sipas QNJ-IKD-së, përveç që ndikon që palët të mos kenë besim në vendimmarrjen e institucioneve, po ashtu e bënë të parëndësishëm edhe ankesën si instrument me të cilin kundërshtohen vendimet administrative dhe kërkohet që një shkallë më e lartë e vendimmarrjes ta trajtoj më me seriozitet objektin e çështjes. Në fakt, një qasje e tillë ia humb edhe kuptimin ankesës si mjet kryesor në një procedurë administrative.

QNJ-IKD vlerëson se në këto raste, duke e ditur se vendimet për këto palë janë marrë duke u shkelur kriteret e përcaktuara me Ligj dhe Rregullore, nga ana e MPMS-së është dashur që të merreshin vendime me të cilin do të ktheheshin në rivlerësim të serishëm dhe rivlerësimi i tyre të bëhej pas ekzaminimit të palëve, analizimit të dokumenteve të reja mjekësore e jo vetëm të atyre të viteve paraprake dhe më pas të

jepej ndonjë konstatim i cili të paktën do të merrej duke zbatuar procedurat e kërkuara me ligj.

Shkeljet ligjore në këtë rast paraqesin mohim të të drejtave të një kategorie të ndjeshme të shoqërisë. Për më tepër, në rastin konkret, një qasje e tillë e institucioneve publike paraqet edhe diskriminim për këtë kategori të qytetarëve.

Por, në MPMS, këtë mënyrë të veprimit e arsyetojnë me gjendjen e krijuar si pasojë e COVID-19, duke thënë se të njëjtit e kanë zbatuar ligjin dhe kanë vepruar në mënyrë profesionale.

“Komisioni vlerësues nuk ka bërë asnjë shkelje sepse punon në bazë të ligjit, shkalla e parë gjithnjë i ekzaminon palët dhe sipas nevojave ju kërkon dokumentacion shtesë. Fakti që jemi në kohë kur me vendim të Qeverisë nuk lejohet të bëhet grumbullimi i njerëzve, madje shumë procedura janë pezulluar, p.sh. (lajmërimi i pensionistëve- çdo gjashtë muaj, pastaj është pezulluar edhe aplikimi për disa skema pensionale, natyrisht që kemi qenë të detyruar për të mos thënë obliguar me vendime ad hoc të Qeverisë për të vepruar ndryshe nga ajo që bëhej në situatë të zakonshme. Në këtë kuptim mendojmë që neve pa dashje mund të kemi lënduar procedurat po kemi qenë të obliguar me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik. Komisioni e ka kry punën në mënyrë profesionale, vlerësimi është bërë në bazë të dokumentacionit që gjindet në dosjen e kërkesës. Punën e komisionit të mëparshëm nuk do ta komentoj” thuhet në përgjigjen e MPMS⁷.

⁷ Po aty.

Por, në përgjigjen për këtë raport, në MPMS kanë thënë se të gjitha dosjet e refuzuara do të rishqyrtohen:

“Drejtori i DP-ve bazuar në gjendjen faktike marrë parasysh një numër bukur të madh të ankesave ka nxjerrë një rekomandim në bazë të cilit komisionet mjekësore të MPMS-së obligohen që t’i rishqyrtojnë të gjitha dosjet e refuzuara të personave para dhe tetraplegjik dhe në bazë të këtij vlerësimi t’ju rekomandojnë ndonjë të drejtë tjetër e cila parashihet me ligjet në fuqi. Në bazë të kriterëve që i kërkon Ligji nr.05/L-067, personave që nuk ju takon kjo kategori do të sistemohen në skemën e PPAK-së (skema e personave me aftësi të kufizuar). Vendimet e MPMS-se për këtë skemë janë gjithnjë bazuar në vlerësimin e komisionit mjekësor dhe si të tilla mund të plotësohen por vetëm me rastin e elaborimit gjegjësisht pasi komisioni mjekësor ta ketë përshkruar komentimin në bazë të cilit ka arritur tek ky rezultat” përfundon përgjigja e MPMS-së për këtë raport⁸.

4. Trajtimi i palëve të QNJ-IKD-së nga ana e MPMS-së

➤ Sh.M k. MPMS

Më 19 maj 2017, Sh.M kishte parashtruar kërkesë për njohjen e të drejtës në kompensim të personave paraplegjik dhe tetraplegjik. Shtatë (7) muaj më pas, dhe atë, më 11 dhjetor 2017, Departamenti i Pensioneve në kuadër të MPMS-së kishte nxjerrë aktvendim me të cilin kishte miratuar kërkesën e Sh.M, për kompensim të personave paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të dytë, në shumën mujore prej 150 euro. Kundër këtij vendimi, Sh.M kishte bërë ankesë me të cilin kishte kërkuar ndryshimin e vendimit ashtu që kishte kërkuar që t’i njihet e drejta dhe të paguhet edhe përcjellësi i tij dhe shtesa financiare për ikontinencë.

Ndaj kësaj ankese, MPMS – Departamenti i Pensioneve, më 23 mars 2018 kishte marrë aktvendim me të cilin kishte refuzuar ankesën e tij, duke lënë në fuqi vendimin e datës 11 dhjetor 2017. Në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se pas shqyrtimit të ankesës, shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe provave materiale mjekësore, në seancën e mbajtur më 15 shkurt 2018 nga mjekë specialistë të lëmisë përkatëse, është konstatuar se ankesa e Sh.M, nuk është në harmoni me Ligjin.

Në procedurën e rivlerësimit, MPMS – Departamenti i Pensioneve, më 2 shtator 2020, kishte marrë vendim me të cilin kishte refuzuar tërësisht të drejtën e Sh.M në kompensim. Deri tek ky vendim thuhet se ka ardhur pas shqyrtimit të shkresave të lëndës lidhur me gjendjen shëndetësore të tij, me ç’rast është konstatuar se i njëjti nuk

⁸ Po aty.

i plotëson kushtet ligjore për vazhdimin e kësaj të drejte.

Edhe ndaj këtij vendimi ai kishte ushtruar ankesë më 8 shtator 2020, me arsyetimin se me nxjerrjen e këtij vendimi, Ministria ka bërë shkelje të dispozitave ligjore dhe gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike. Me këtë ankesë, ai ka kërkuar që t'i njihet e drejta në kompensim dhe si kujdestare personale të jetë nëna e tij, F.M.

Lidhur me këtë ankesë, MPMS sërish ka nxjerrë vendim më 4 nëntor 2020, me të cilin të njëjtën e ka refuzuar. Siç thuhet në arsyetimin e këtij vendimi, pas vlerësimit nga mjekët specialist të lëmisë përkatëse të cilët kanë bërë ekzaminimin e dokumentacionit mjekësor, është konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore.

➤ **U.B k. MPMS**

Më 13 shkurt 2018, MPMS-ja – Departamenti i Pensioneve kishte nxjerrë vendim me të cilin ka miratuar kërkesën e U.B në kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të dytë, në shumë mujore prej 150 euro. Pas rivlerësimit, ky departament, më 1 shtator 2020 nxori vendim me të cilin ka refuzuar të drejtën në këtë kompensim ndaj U.B. Në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se komisioni mjekësor i përbërë nga mjekët specialist ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdimin e të drejtës në kompensim.

Ndaj këtij vendimi, paditësja kishte ushtruar ankesë më 17 shtator 2020, me arsyetimin se Ministria ka bërë shkelje të dispozitave ligjore dhe gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike.

Kjo ankesë ishte refuzuar më 23 tetor 2020 nga MPMS, duke u bazuar në vlerësimin e komisionit mjekësor, të cilët pas ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor kanë konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensim.

➤ **K.S k. MPMS**

Më 13 shkurt 2018, MPMS – Departamenti i Pensioneve kishte miratuar kërkesën e K.S, të parashtruar më 5 qershor 2017, në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të dytë, në shumë mujore prej 150 euro.

Mirëpo pas rivlerësimit, më 1 shtator 2020, kjo e drejtë i ishte refuzuar me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdimin e të drejtës në kompensim, sepse gjendja shëndetësore e K.S-së nuk është në harmoni me Ligjin. Ndaj këtij vendimi, më 21 shtator 2020, ishte parashtruar ankesë, e cila ankesë ishte refuzuar me vendimin e datës 26 tetor 2020 të nxjerrë nga MPMS.

Në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se pas ekzaminimit mjekësor të bërë nga mjekët specialist, është konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensim.

➤ **V.V k. MPMS**

V.V, kishte parashtruar kërkesë më 24 gusht 2017 për njohjen e të drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, ku pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, MPMS e kishte miratuar të njëjtën, duke ia njohur të drejtën në kompensim në grupin e dytë.

Më 21 qershor 2018, V.V kishte ushtruar padi në Departamentin për Çështje Administrative për anulimin e vendimit të nxjerrë më 13 mars 2018 nga MPMS. Ky

vendim, sipas padisë, përbën shkelje të dispozitave ligjore meqë paditëses nuk i është njohur e drejta për përfitimin e këtij kompensimi në grupin e parë.

Po ashtu, në padi thuhet se me rastin e marrjes së këtij vendimi, MPMS, përkatësisht komisioni vlerësues gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, meqë sipas raporteve mjekësore dhe gjendjes reale faktike, është konstatuar aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme e paditëses.

Departamenti i Pensioneve i MPMS-së, pas rivlerësimit të V.V, më 1 shtator 2020, duke shkelur ligjin dhe rregulloren, kishte nxjerrë aktvendim me të cilin kishte refuzuar të drejtën në kompensim, duke konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore dhe se gjendja e saj është përmirësuar.

Por pas më pak se një muaj më pas, Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë, më 16 tetor 2020, kishte marr aktgjykim me të cilin kishte aprovuar kërkesëpadinë e V.V si të bazuar, duke ia njohur të drejtën në kompensim në grupin e parë, në shumë prej 375 euro dhe në këtë mënyrë kishte anuluar vendimin e MPMS-së të vitit 2017.

➤ **I.M k. MPMS**

Më 11 dhjetor 2017, MPMS kishte miratuar kërkesën e I.M, duke ia njohur të drejtën në kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e dytë.

Tre vite më pas, I.M. i ishte nënshtruar rivlerësimit, por më 19 gusht 2020,

paditësit i ishte refuzuar e drejta në kompensim. Në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se komisioni mjekësor ka shqyrtuar shkresat e lëndës lidhur me gjendjen shëndetësore dhe ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore meqë gjendja shëndetësore e I.M, nuk është në harmoni me Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Kundër këtij vendimi, paditësi kishte ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave për shkak të aplikimit të gabueshëm të ligjit si dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabueshëm të gjendjes faktike. Në ankesë thuhet se gjendja e I.M-së, nuk ka ndryshuar, vetëm sa është përkeqësuar dhe nuk është në gjendje të lëvizë i vetëm pasi që i njëjti është i paaftë për jetë të pavarur dhe nuk është i aftë të kujdeset për veten e tij.

Por kjo ankesë, me vendimin e MPMS-së të marrë më 2 nëntor 2020, është refuzuar si e pabazuar. Në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë, është vërtetuar se ankesa nuk është në harmoni me Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Po ashtu, në arsyetim thuhet se pas ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor nga komisioni mjekësor, është konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensim.

5. Rekomandime

- I. QNJ-IKD rekomandon MPMS-në që në çdo procedurë të rivlerësimit, ashtu siç e kërkon ligji dhe rregullorja, të bëj ekzaminimin fizik të personave dhe të kërkoj nga ta dokumentacione shtesë e jo të mjaftohet me ato të viteve paraprake.
- II. Në rastet kur palët të cilat i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit pa u zbatuar procedurat ligjore të vlerësimit, Komisioni i Ankesave të MPMS-së të kthej në rivendosje në shkallën e parë ose t'i ftoj palët që atyre t'u bëhet ekzaminimi fizik dhe i dokumentacionit shtesë
- III. Marrë parasysh situatën me pandeminë Covid-19 dhe situatën e vështirë financiare me të cilën përballën personat që me rastin e rivlerësimit janë refuzuar dhe më nuk marrin asnjë kompensim nga shteti, MPMS-ja të ndërmerr hapa të shpejtë përmes thirrjes publike në faqen e tyre, në televizione dhe rrjete sociale, të bëj thirrje publike që të gjithë personat që janë rivlerësuar pa u bërë ekzaminimi fizik, të ftohen që të ri-aplikojnë dhe brenda një afati të arsyeshëm të bëhet rivlerësimi i tyre
- IV. Me rastin e refuzimit të kërkesës apo ankesës së aplikuesve, Komisioni Vlerësues dhe Komisioni i Ankesave të MPMS-së, të nxjerrin vendime me arsyetime të detajuara për arsyet e refuzimit të kërkesave/ankesave e jo të përdorin vetëm shabllone me të cilat nuk evidentohen arsyet e refuzimit.
- V. MPMS-ja të ndërmerr hapa me të cilat do t'i nxjerrë para përgjegjësisë zyrtarët apo komisionet mjekësore, të cilët kanë shkelur procedurat ligjore me rastin e rivlerësimit të personave të cilat më parë kanë fituar statusin e personave paraplegjik apo tetraplegjik
- VI. Prokurori i Shtetit të hetoj nëse ka dyshim të arsyeshëm se zyrtarët apo komisionet mjekësore të MPMS-së kanë shkelur procedurat ligjore me rastin e rivlerësimit dhe nëse i është shkaktuar dëm personave të caktuar nga kjo kategori e ndjeshme shoqërore.